

Nxitje e mbështetje që nga lindja

Nxitja e zhvillimit të fëmijëve dhe mbështetja e tyre gjatë zbulimit me anë të lojës

Mirë se vini në zeppelin- familjet të gatshme për të startuar

Ne ju mbështesim juve si nënë dhe baba me anë të programit „PAT – Të Mësuarit me Prindërit“ në nxitjen dhe mbështetjen e zhvillimit të hershëm të fëmijëve tuaj. Si prindër ju keni një ndikim të madh në zhvillimin dhe mësimin e fëmijës tuaj. Zeppelin-familjet të gatshme për të startuar ju ofron informata, udhëzime dhe mbështetje për përditshmërinë familjare.

Si funksionon PAT – Të mësuarit me Prindërit

- PAT Trajnerja do të vijë dy herë në muaj (çdo dy javë) te ju në shtëpi dhe do të qëndrojë te ju një orë derisa fëmija juaj të bëhet dy apo tre vjet.
- Një herë në muaj do të merrni pjesë me fëmijën tuaj në programin që ua ofron komuna juaj.

Vizita në shtëpi

- Koha e vizitës në shtëpi ju përkushtohet juve dhe fëmijës tuaj.
- Ju do të mund të flisni me trajneren për prindërit për zhvillimin, edukimin, shëndetin e fëmijës tuaj dhe do ta keni mundësinë t'i shtroni pyetjet tuaja për gjërat që u interesojnë. Bisedat zhvillohen në besueshmëri të plotë.
- Ju do të mund të luani bashkë dhe do të krijoni ide të reja si ta nxisni e mbështetni fëmijën tuaj.

Ofertat grupore

- Ju do ta keni mundësinë të takoni familje të tjera dhe me to të shkëmbeni përvojat tuaja.
- Do ta keni mundësinë të hani bashkë pasdreke.
- Do t'i njihni ofertat tjera për familjet në afërsi të vendbanimit tuaj.
- Fëmijët do të kenë mundësi të luajnë me fëmijët e tjerë.

Çka mund të arrini ju dhe fëmija jua?

- Ju do të fitoni siguri në edukimin e fëmijës suaj.
- Do të kuptoni se çka ju nevojitet fëmijëve tuaj që të rriten e të jenë të shëndosh.
- Do të merrni përgjigje në pyetjet tuaja.
- Do të mund ta përgatisni si duhet fëmijën tuaj për kopshtin e fëmijëve dhe për shkollë.

Kush mund të merr pjesë?

Gratë shtatzëna dhe prindërit e fëmijëve me situata të ngarkuara, të cilët nuk janë më të mëdhenj se katër muaj.

Pjesëmarrja është vullnetare dhe pa shpenzime. Largimi i parakohshëm nga programi është i mundshëm.

Ku mund të informoheni?

- Te këshilltarja juaj për nënat
- Te akusherja juaj
- Te mjeku/mjekja juaj i fëmijëve